

Nr. 5274/1 Prot
06.08.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 580/1 prot.

Shkodër, më 04.09.2024

Lënda: Mbi Vendimet Nr. 59 & Nr.63, datë 28.08.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1, nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54, shkronjat “a” & “m”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, dokumentacioni i mbledhjes të këshillit bashkiak bashkëlidhur vendimit nr.5272 prot, datë 03.09.2024 u njoh me vendimet Nr. 59 & Nr.63, datë 28.08.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës “Për plotësim të vakancave të komisioneve të Këshillit Bashkiak” dhe “Dhënie titull nderi z.Dom Nikson Shabani”, akte me karakter jo normativ. Emrat e përfutueseve (nominalisht) nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit “Për Prefektin” i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Të keni në vëmendje se tashmë ka hyrë në fuqi ligji Nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në RSH”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 63 Datë. 28 / 08 /2024

“PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË VAU DEJËS

Z.Dom Nikson Shabani”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të Nenit 54, **pika “m”** Të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të neni 3, **pika 1**; neni 14, **pika 1**; neni 15, **pika 1/a dhe 2**; neni 16, **pika 1**; neni 17; neni 18; neni 19; neni 20, **pika “ç”**, të ligjit Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Të neni 113, pika “dh”, të ligjit Nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, **Z.Dom Nikson Shabani** vendbanues në Vjene të Austrisë, me motivacionin: **“Kontributin e vazhdueshëm për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës”**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika **6**, e ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

Sekretari Këshillit

Ardian Çelepija

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.09.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Vau Dejës, _____.____.2024

Nr ____ Prot

PROJEKT-VENDIM

Nr. 4 Datë. 15.08.2024.

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË VAU DEJËS
Z.Dom Nikson Shabani

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të Nenit 54, **pika "m"** Të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; të neni 3, **pika 1**; neni 14, **pika 1**; neni 15, **pika1/a dhe 2**; neni 16, **pika 1**; neni 17; neni 18; neni 19; neni 20, **pika "ç"**, të ligjit Nr. 112/2013 "Për dekoratat,titujt e nderit,medaljet dhe titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Të neni 113, pika"dh", të ligjit Nr.8417,datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; me Propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI :

- 1.T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Vau Dejës, **Z.Dom Nikson Shabani** vendbanues në Vien të Austrisë, me motivacionin: "**Kontributin e vazhdueshëm për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës**".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika 6, e ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETARI

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr ____ Prot

Vau Dejës, _____.____.2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI”

Z.Dom Nikson Shabani

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; në ligjin 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pas vlerësimit të kërkesës të bërë për dhënien e titullit qytetar nderit **Z.Dom Nikson Shabani** me qëllim që të vlerësohet puna, kontributi: Këshilli i Bashkisë Vau Dejës duke konsideruar propozimin e bërë u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë që të vlerësohet figura dhe personaliteti i **Z.Dom Nikson Shabani**, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohje publike për të gjithë kontributin dhe punën në funksion të komunitetit:

T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, **Z.Dom Nikson Shabani** vendbanues në Vien të Austrisë, me motivacionin: **“Kontributin e vazhdueshëm për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës”**.

Ky titull jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për gjithë kontributin tij në mbështetjen e vazhdueshme për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës. Atë e karakterizon gjithmonë respekti për njerëzit e thjeshtë, të punës dhe të dijes.

1.Për të gjitha meritat propozohet t’i akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë Vau Dejës”.

KRYETARI

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

KRYETARI

Nr. 4749 prot.

Vau Dejës, më 07.08.2024

PROPOZIM PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkatësisht Neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54 gërma m);

Neni 9, pika 1.7, gërma a)... Të drejtat dhe përgjegjësitë, 1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:

a) japin tituj nderi dhe stimuj;

Neni 54 gërma m) Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, m) jep tituj nderi dhe stimuj;

Ligji nr 94/2023 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”,

KREU III / Neni 8, neni 9; KREU IV / Neni 11, pika 2 gërma a; neni 13:

Neni 8, Llojet e titujve vendorë të nderit....Titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë janë titulli “Qytetar nderi” dhe tituj të veçantë vendorë nderi që jepen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 9, Titulli “Qytetar nderi” 1. Titulli “Qytetar nderi” jepet nga këshilli bashkiak për veprimtari të shquar, kontribute dhe merita të veçanta në shërbim dhe në dobi të bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të bashkisë.

2. Titulli “Qytetar nderi” u jepet edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë, që vizitojnë një bashki në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore.

Neni 11, pika 2, Propozimi për dhënie të titullit vendor të nderit paraqitet nga: a) kryetari i bashkisë;

Neni 13, Propozimi për nderim

Mbështetur në legjislacionin e parashikuar për dhënie të titujve të nderit, duke e respektuar parashikimet e tij, duke legjitimuar nga neni 11, pika 2 e Ligjit nr.94/2023, propozoj dhënie të titullit “Qytetar nderi” për:

Z. Dom Nikson Shabani, propozohet t’i jepet titulli “Qytetar Nderi”, me motivacionin “Kontributin e vazhdueshëm për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës”.

Historik i shkurtër:



1. I shuguruem me 04.08.2001 në Stubëll.
 2. Mesha e parë me 05.08.2001 në Stubëll.
 3. Në vitet 2001-2004 prefekt në Selinarin "Lazër Mjeda" në Prizren dhe kapelan në famullinë e "Zojës Ndhimëtare" në Prizren.
 4. Në vitet 2004-2006, kapelan në famullinë "Santa Maria Maggiore" në Terni të Italisë. Këtu e ka organizuar komunitetin shqiptar dhe ka thanë meshë në gjuhën shqipe me besimtarët e Lezhës e rrethinë që jetojnë atje.
 5. Në vitet 2006-2009 famullitar i Katedralës së Tivarit e famullitar i famullisë së Zupçit në Mal të Zi. Ku e ka i ringjallur këto dy famulli dhe ka organizuar shqiptarët rreth Meshës në gjuhën shqipe.
 6. Në vitet 2009-2011 famullitar në Prishtinë.
 7. Në vitet 2011-2012 famullitar i Katedralës në Prizren.
 8. Në vitet 2012-2024 misionar i Misionit Katolik Shqiptar në Austri me seli në Vjenë, i cili Mision mbulon 13 qytete ne Austri si dhe Pragën në Çeki dhe Bratisllavën në Sllovaki. Si meshtar Dom Niksaon Shabani shquhet per formen shpirtërore te predikimit te Fjales se Zotit dhe afersine me besimtarët, jo vetem te krishtere dhe katolike, por edhe ortodokse, muslimane dhe besimeve te tjera, prezente sidomos ne Austri, ndesa si misionar shquhet me vullnetin e madh per misionin e paqes e besimit ne Zotin dhe misionin e perhapjes së kulturës e tradites shqiptare, që ishte ndër të parat që I dha hapësire misionit të paqes sipas Mësimeve te Jezu Krishtit dhe e perhapi nga Iliria deri ne Rome e pastaj neper Evrope e pertej saj.
- Dom Nikson Shabani është edhe hulumtues erudit i arkivave te Vjenes ne te cilat tash e sa vite me vullnet e përkushtim të madhe mbedh dokumente që kanë të bëjnë me historinë tone, kulturen e traditen që nga lashtësia e deri më sot. Kështu deri me tash ka arritur të mbledh mbi 200 mije dokumente, të cilat janë jo vetem me rendesi te madhe per historine e historianet tone, por një pjese do të shohin për herë te parë driten publike, si pjesë e nje Biblioteke shume te pasur, ne te cilen do te vihet ne pahe ndihma e madhe e ish.Monarkise Austro-Hungareze për gjuhen shqipe dhe mesimin e saj, kulturen tone dhe pavarësinë e Shqipërise. Pos këtyre meshtarise e perkushtimit per hulumtime të arkivave Dom Niksoni shquhet edhe per organizime kulturore, sikur jane koncertet klasike ne Kishen e Misionit ne Vjene, me muzikante e këngëtare shqiptare e austriake[1], apo me simpoziume shkencore, sikur me rastin e 25 Vjetorit te Misionit Katolik Shqiptar ne Austri, ku jo vetem qe moren pjese historiane te shquar austriake e shqiptare me punimet e tyre shkencore[2], por u thane lavdatat më të larta për këto organizimet në Kishen e Misionit, sikur u shpreh Kardinali i Vjenes Kardinal Schönborn, në fjalën e tij përshendetese me 16 Nentor 2018:



"JU JENI NJE DHURATE PER QYTETIN E VJENES"![3] Last but not liest, Dom Niksoni shquhet për veprimtarine e tij humane, te cilen gjate sherbimit te tij 12 vjecar ne Misionin Katolik Shqiptar ne Austri e ka shprehur ne formen e mbledhjes së ndihmave për familje të prekura nga varferia ne Kosove e Shqiperi.

Gjithashtu Z.Dom Nikson Shabani ka kontribuar **ne (ri)ndertimin e shtepive, apo pajisjen e tyre, ndërmjet të cilave janë edhe 13 familje nga Bashkia e Vaut te Dejes.**

KRYETARI

Kristian Shkreli





BASHKIA VAU DEJËS

KOMISIONI KËSHILLIMOR

Nr. 449/prot.

Vau Dejës, më 08.08.2024

I mbajtur sot me datë 08.08.2024 në Bashkinë Vau Dejës, pas Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës për **“Për krijimin e komisionit këshillimor për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendor të nderit”**, kemi marrë në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës për dhënien e titullit **“Qytetar nderi”**, për:

Z. Dom Nikson Shabani, me motivacionin **“Kontributin e vazhdueshëm për 10 vitet e fundit në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës”**.

Pas marrjes së propozimit të bërë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, i cili legjitimohet të bëjë këtë propozim mbështetur në Nenin 11, pika 2, Të Ligjit nr 94/2023 **“Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”**, mbështetur në nenin 16 të po këtij ligji, u bë shqyrtimi i propozimit **dhe u vendos miratimi i propozimit**, për shkak se propozimi i paraqitur nga kryetari i plotëson kriteret nga neni 13 i ligjit 94/2023.

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Donima dmi
2. Stefoni Jaku
3. Kristine Shkupi
4. Petrit Behari
5. Eduard Paloka